



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:813/26, Datë: 28.05.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 149 të mbajtur më 18.05.2026, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohen programet e studimeve të Universitetit të Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):
 1. *Mekatronikë, MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik;*
 2. *Mekatronikë, BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
- II.** Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III.** Obligohet Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV.** Obligohet Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim, vetëm nga KShC.
- V.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Mekatronikë, MSc 120 ECTS	Ahmet Shala Shpetim Lajqi
2.	Mekatronikë, BSc 180 ECTS	Rame Likaj Xhevahir Bajrami Ilir Murturi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; Mekatronikë, MSc 120 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar me datë 23.04.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandime ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit;
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

2. Për programin e studimit; Mekatronikë, BSc 180 ECTS vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar me datë 23.04.2026.

Ekipi i ekspertëve në raportin final me rekomandime ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit;
- Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit

Bazuar në kompetencat dhe diskrecionin në vendimmarrje KShC ka vlerësuar se të dy programet kishin fusha me përmbushje të pjesshme të fushave të standardeve, prandaj dhe përtej rekomandimit të ekipit të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, programet riakreditohen për periudhën tre (3) vjeçare me numër të studentëve si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 149-të, të mbajtur më datë 18.05.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit të Prishtinës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe duke u bazuar në raportet e ekipit të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit pas realizimit të vizitave si dhe rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës – FIM;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

